REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:216267
Datë: 24.10.2023
Numri i dokumentit: 04824056

PPP.nr.23/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni civil-përmbarimor, gjyqtari Nehat Qelaj, me bashkëpunëtor profesional Samir Morina, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores Sh. A (K...)Prishtinë, kundër debitorit N.M, nga Malisheva, duke vendosur lidhur me prapësimin me nr. proto: 124/2020, të datës 12.06.2020, kundër urdhërit të përmbaruesit privat Ymer Kastrati në Malishevë, P.nr. 16/2020 të datës 24.02.2020, me objekt pagesë e borxhit në vlerë prej 755.79 €uro, jashtë seancës, më datë 24.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET I TËRHEQUR prapësimi i debitorit N.M, nga Malisheva, ndaj urdhërit të përmbaruesit Ymer Kastrati në Malishevë, P.nr. 16/2020 të datës 24.02.2020, të kreditores Sh. A (K...)Prishtinë, me objekt pagesë e borxhit në vlerë prej 755.79 €uro, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

II. MBETËT NË FUQI urdhëri për lejimin e përmbarimit i përmbaruesit privat Ymer Kastrati në Malishevë, P.nr. 16/2020 të datës 24.02.2020, në ketë çështje përmbarimore.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta deri në këtë fazë të procedurës.

A r s y e t i m

2022:216268

Sipas propozimit të kreditores Sh. A (K...)Prishtinë, përmbaruesi privat Ymer Kastrati në Malishevë, P.nr. 16/2020 të datës 24.02.2020, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste, kundër debitorit N.M, nga Malisheva, për shkak të borxhit në shumën e përgjithshme prej 755.79 €uro, lidhur me shfrytëzimin e shërbimeve të energjisë elektrike për periudhën prej datës 23.08.2019 e deri më datë 07.01.2020.

Gjykata me vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore PPP.nr. 23/2020 të datave 30.06.2020 (*të cilën nuk ka prova në shkresat e lëndës që debitori e ka pranuar në mënyrë të rregullt),* ka dorëzuar përsëri vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore PPP.nr. 23/2020 të datës 29.09.2023, ku e ka ftuar debitorin që në afat prej 7 ditësh ta paguajnë taksën gjyqësore për prapësim, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguajnë do të konsiderohet se e kanë tërhequr prapësimin.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se më datën 09.10.2023, zyrtarët e shërbimit të PTK-së, ku kanë shënuar se: "*vëllezërit refuzuan ftesën, thonë që pala gjendet në Gjermani*", që në këtë rast për gjykatën kjo formë e dorëzimit është e ligjshme dhe konsiderohet sikurse debitori të ketë pranuar vërejtjen për taksë gjyqësore, ndërsa nuk ka prova në shkresat e lëndës që debitori e as përfaqësuesi i autorizuar të kenë bërë pagesën e taksës së kërkuar për prapësim.

Sa i përketë pretendimeve të ngritura në prapësim si dhe atyre në përgjigje në prapësim, gjykata nuk është lëshuar fare në shqyrtimin e tyre, për shkak se nuk është përmbushur dispozita nga neni 253 par. 5 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

Gjykata me rastin e vendosjes mori për bazë nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), ku përcaktohet se: "*Në procedurën përmbarimore përshtatshmërish zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër".*

Për gjykatën nuk ishte i kundërligjshëm komunikimi zyrtar me debitorin, pasi që një formë e tillë e komunikimit është paraparë në Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përkatësisht në neni 111 par. 1 i cili përcakton se: "*Po që se personi të cilit duhet bërë dorëzimi i shkresës nuk gjendet në banesën e vet, dorëzimi bëhet duke iu dhënë shkresa ndonjë anëtari të rritur të familjes së tij, i cili ka për detyrë ta marrë shkresën në dorëzim, e po që se as*

2022:216268

këta nuk gjendën në banesë, shkresa do t'i jepet fqinjit, po që se pajtohet me një gjë të këtillë. Dorëzimi i kryer në këtë mënyrë konsiderohet i vlefshëm", gjë që në ketë rast anëtarët e rritur të familjes, respektivisht vëllezërit e debitorit e kanë refuzuar pranimin e vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore dhe as nuk është bërë pagesa e taksës gjyqësore për prapësim, atëherë për këto arsye është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 253 par. 5 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se: "*në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr",* prandaj, në ketë rast janë përmbushur në tërësi kërkesat ligjore që parashihen me dispozitën e lartcituar, për çka gjykata nuk kishte si të vendoste ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Duke marr parasysh faktin se as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, debitori nuk e kanë bërë pagesën e taksës për prapësim brenda afatit të përcaktuar, madje as deri më tani kur nga koha dorëzimit të vërejtjes më datë 09.10.2019 e gjeri më tani ka kaluar 15 ditë kalendarike nga koha e refuzimit të vëllezërve për pranimin e vërejtjes, ndërsa gjykata nuk ka bazë se ekzistojnë kushtet për lirimin e tij nga pagesa e të njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 253 par. 5 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c) të LPK-së.

Gjykata ka vendosur që shpenzimet procedurale ti bartin secila nga palët, konform nenit 450 të LPK-së, i cili përcakton se: "*Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta*", andaj në ketë rast duke marrë parasysh faktin se deri në ketë fazë të procedurës nuk është vendosur për çështjen kryesore atëherë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 17 si dhe nenit 73 par. 1 të LPP-së, lidhur me nenin 253 par. 5 lidhur me nenin 387 par. 1 pika c), nenit 450 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA MALISHEVË,
Depertamenti i Përgjithshëm/Divizionin civil-përmbarimor,

PPP.nr. 23/2020, më datë 24.10.2023.

Gj y q t a r i

Nehat Qelaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, pasi të jepen garancitë për shumën e plotë të kredisë, konform nenit 78 të LPP-së, në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes gjykatës së shkallës së parë, në ekzemplar të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën